

URDHËR
Nr. 69, datë 17.3.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të ligjit nr. 9000, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, për miratimin dhe nënshkrimin e autorizimeve në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe shkresat përcjellëse drejtuar ministrive homologe, palë në marrëveshje në fushën e transportit ndërkombëtar rrugor, zëvendësministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Hantin Bonati.

2. Z. Hantin Bonati, të ndjekë dhe zbatojë kriteret dhe procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, dhe pikave 7.5.2 dhe 8.2 të udhëzimit nr. 8, datë 19.12.2019, “Për kriteret, rregullat dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve”.

3. Urdhri nr. 13, datë 13.1.2026, i zëvendëskryeministrit dhe i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, “Për delegim kompetence”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Hantin Bonati, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi